



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1716/24 Datë: 20/08/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 127-të, mbajtur me datë 12.08.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Zgjatet periudha e riakreditimit të programeve të arteve të Kolegjit AAB kampusi kryesor për periudhën një (1) vjeqare 01.10.2024 deri 30.09.2025, për programin e studimve:
 - Dizajn Grafik dhe Art Vizuel BA 180 ECTS (R)
 - Dizajn Grafik MA 120 ECTS (R)
- II. Për këtë periudhë të riakreditimit vlejné kriteret dhe kuotat e njëjta sikurse në vendimin e fundit të KShC-së Ref.3030/21 datë 12.08.2021, me të cilin ishte riakredituar programet si në par. I të këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Kolegji AAB brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Dizajn Grafik dhe Art Vizuel BA 180 ECTS (R)	Fisnik Ismajli Liridona Abdullahu Agon Nimani Clirim Vokshi Miran Kozmaqi
2.	Dizajn Grafik MA 120 ECTS (R)	Luan Tashi Leonita Fazliu

KShC fillimisht kishte vendosur që të refuzohen programet e fushës së Arteve për shkak të mungesës së bazës ligjore përkatësisht zbrazëtisë ligjore për këtë çështje (kalimi i afatit të *Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.02/2019* me datë 31.01.2019).

Mirëpo më pas KShC pas pranimi të *Udhëzimit të ri administrativ (MASHTI) 01B-03/2024* për vlerësimin e përshatshmërisë së bartësve të programeve studimore si dhe programeve nga radhët e komuniteteve jo shumicë në procesin e akreditimit dhe riakreditimit të institucioneve të arsimit të lartë, nënshkruar me datë 25.07.2024 i cili adreson edhe çështjen e bartësve të programeve të arteve, ka marr në rishqyrtim kërkesën për programet e bashkëngjitura në tabelë me bartësit përkatës dhe pas rishqyrtimit ka ardhur në përfundim të riakreditoj programin *Edukim në Muzikë Bachelor i Arteve 240 ECTS (R)* për një periudhë një (1) vjeqare.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 127-të, mbajtur me datë 12.08.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegji AAB dhe duke u bazuar në kompetencat ligjore, autorizimet dhe diskrecionin, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji AAB;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë